



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit  
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode  
Water Services Regulatory Authority  
Nr. prot./Prot. Dr./Prot. No. 1117  
Njësia/Jedinstvo/Uj... D  
Nr. shërb./Shërb./Service No.  
Data/Data/Datum 30.12.2024  
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

30. 12. 2024

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016, dhe komfor nenit 29 të Rregullores së ARRU Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë qershor 2020, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifar të DT, për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

## V E N D I M

### për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e N. H "Ibër Lepenc" sh. a Prishtinë (ARRU/UTSH-15/08/2025), për aktivitetet themelore të shërbimit të ujit të patrajtuar me shumicë.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përfshijet TVSH), për shërbimet themelore.
3. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të N. H "Ibër Lepenc" sh. a, në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe në pajtim me nenin 30 dhe 31 të Rregullores 12/2020 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
4. N. H "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjetësve Regjional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifën e Shërbimit të përcaktuar nga ARRU-ja, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose t'u dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit ; [www.arru-rks.org](http://www.arru-rks.org).
5. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojnë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
6. UTSH, hyn në fuqi më 1 janar 2025 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2025 (01.01-31.12.2025).

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.

Dërguar:

1 x 1 Arkivit të ARRU

1 x 1 Departamentit të Tarifave

1 x 1 Krye shefit Ekzekutiv të N. H "Ibër Lepenc"



Hajrije Morina  
Drejtoreshë e ARRU



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-17/08/2025

# URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

N. H "IBËR LEPENC" SH. A PRISHTINË PËR VITIN 2025

E aplikueshme për:

KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë  
KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë

## Pasqyra e tarifave të shërbimit

NH "Ibër-Lepenc" Sh. A. Prishtinë për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë periudhës tarifore 01. 01 deri më 31. 12. 2023 nga procesi i tariforë për vitin 2023 sikurse janë dhënë në tabelën e më poshtme:

*Tabela 1: Tarifat e ujit të pa trajtuar me shumicë*

| <i>Numri rendor</i> | <i>KRU-të</i> | <i>Njësia tarifore</i> | <i>Viti 2025</i> |
|---------------------|---------------|------------------------|------------------|
| 1                   | Mitrovica     | €/m <sup>3</sup>       | 0.0204           |
| 2                   | Prishtina     | €/m <sup>3</sup>       | 0.0435           |

### *Shënim:*

*Për KRU "Mitrovica" sh. a Mitrovicë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shipol të Mitrovicës, dhe për Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Balinc të Vushtrrisë.*

*Për KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shkabaj të Prishtinës, dhe për Fabrikën përpunimit të ujit në Drenas.*